



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 343 Prot

Tiranë, më 17 / 2 / 2021

VENDIM

Nr. 05, datë 17.2.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1694 Prot., datë 29.12.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet shkresës datë 11.11.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion kopje të vendimeve gjyqësore që lidhen me sekuestron preventive në zbatim të Kodit të Procedurës Penale për periudhën 2010 – 2020, si më poshtë:

1. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 – 2020 me objekt: “Vendosjen e sekuestron preventive” të pasurive që dyshohet se janë produkt i veprimtarisë kriminale, në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal.
2. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 - 2020 me objekt: “Revokimin/heqjen e sekuestron preventive” të pasurive të dyshuara si produkt i veprimtarisë kriminale, të marra në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal.
3. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 - 2020 me objekt: “Konfiskimin e pasurisë”, në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, pasi vendimet e vendosura në dispozicion nga Autoriteti Publik janë anonimizuar duke mos mundur kuptimin e tyre

për qëllime studimore, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: “*Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve*”, si dhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19 dhe në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/video-call), në datën 22.01.2021, ora 11.00 me prezencën e palëve.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar më sipër.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik, sqaruan ndër të tjera se: “*...kanë vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar bazuar në Udhëzimin nr. 4059/2, datë 07.06.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”, i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave mbi anonimizimin e të dhënave personale që përmbajnë vendimet gjyqësore*”.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoj përfaqësuesve të Autoritetit Publik për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur në përputhje me udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 28.01.2021 ka kthyer përgjigje duke sqaruan ndër të tjera se: “*Nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është trajtuar kërkesa e subjektit Edmond Hoxhaj dhe në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore i janë vënë në dispozicion vendimet e kërkuara të anonimizuar sipas udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe udhëzimit nr. 4059/2, datë 2016 të Ministrit të Drejtësisë. Anonimizimi është bërë i plotë dhe i rregullt sikurse e kërkojnë aktet nënligjore të cituara me sipër. Në takimin e zhvilluar online, u sqarua se Gjykata duhet të marrë në konsideratë udhëzimin nr. 15 datë 23.12.2011, por vlerësohet se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në vendimmarrjen përfundimtare duhet të ketë parasysh faktin që akti i nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë është detyrues për sa kohë ka dalë në vitin 2016, kohë në të cilën KLGJ si organ i qeverisjes së gjyqësorit nuk ishte krijuar ende dhe duke qenë se deri në këtë kohë shumë prej veprimtarive të gjykatave normoheshin nga aktet e nxjerra*”.

nga MD-ja. Rrjedhimisht, edhe ky akt ka qenë i detyruar për t'u zbatuar nga ana e gjykatës.

Në këtë rast kemi konkurim në lidhje me zbatueshmërinë e dy akteve, të cilët janë në fuqi dhe të zbatueshëm, por zbatueshmëria e tyre nuk i takon gjykatës. Për normimin e punës së gjykatës në lidhje me anonimizimin tashmë me ngritjen e KLGJ-së i takon kësaj të fundit të nxjerrë aktet ligjore për këtë problematikë, por që deri në zgjidhjen e kësaj çështje, vlerësojmë se zbatueshmërinë e akteve duhet ta zgjidhin organet tona eprore (KLGJ).

Nga sa u parashtrua në seancë nga përfaqësuesja e ankuesit u cita ndër të tjera se: "... vendimet gjyqësore të kërkuara kanë të dhëna që janë në interes të lartë publik në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit..", por në fakt asnjë citim i tillë nuk është përmendur në kërkim. Kërkimi ishte për vendimet gjyqësore në vitet nga 2010 – 2020 me bazë ligjore nenin 278 të Kodit Penal, ndër to mund të kishte edhe vendime "që janë në interes të lartë publik në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit", por nuk është përmendur asgjë konkretisht. Nga gjykata jonë i janë dërguar 164 vendime gjyqësore, të gjitha të anonimizuara".

Në vijim, me e-mail-in datë 02.02.2021, ankuesi kërkon nga Komisioneri detyrimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të vendimeve të plota, të anonimizuara vetëm për të dhënat që janë sensitive dhe të lidhura me persona të tretë.

Bazuar në sa më sipër, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI në të cilën parashikohet se, "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Për sa i përket legjitimitimit të kërkuarit, Komisionerit thekson se LDI nuk kushtëzon dhënien e informacionit/dokumentacioni të konsideruar publik me paraqitjen nga ana e kërkuarit të arsyeve apo interesit që ka në marrjen e këtij informacioni. Për më tepër, kërkuari/ankuesi është përfaqësues i një organizatë jo-fitimprurëse (BIRN Albania), që ka për qëllim kryesor promovimin e medias të lirë dhe të pavarur, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me korrupsionin, pandëshkueshmërinë, situatën e të drejtave të njeriut, si dhe aktivitetin e shoqërisë civile në Shqipëri dhe rajon, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik në luftimin e veprimtarive kriminale.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë e cila konsiston në vënien në dispozicion të vendimeve që përmbajnë informacion për sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive të personave të akuzuar si pjesë e krimit të organizuar, të cilat rrjedhimisht përbëjnë një interes për publikun.

Nga verifikimi i dokumentit të anonimizuar, si dhe nga qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, konstatohet se ky i fundit, ka bërë anonimizimin në përputhje me Udhëzimin

nr. 4059/2, datë 07.06.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave", i cili ka për qëllim përcaktimin e rregullave mbi anonimizimin e të dhënave personale që përmbajnë vendimet gjyqësore.

Komisioneri e gjen anonimizimin e bërë nga Autoriteti Publik jo në përputhje me rregullimin ligjor në fuqi. Ndryshe nga sa argumenton Autoriteti Publik, nuk jemi përpara konkurimit lidhur me zbatueshmërinë e dy akteve rregullatore, por jemi përpara interpretimit dhe zbatimit të gabuar të Udhëzimit nr. 4059/2, datë 07.06.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave" të Ministrit të Drejtësisë, nga ana e Autoritetit Publik.

Neni 29 i Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, në pikën "1" të tij parashikon se: *"Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit është autoriteti përgjegjës i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut"*.

Në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 30 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar parashikohet se: *"Komisioneri ka të drejtë të japi udhëzime përpara se përpunimet të kryhen....."*, ndërkohë në shkronjën "f" të pikës 1 të nenit 31 të ligjit të sipërcituar parashikohet se: *"Komisioneri është përgjegjës për nxjerrjen e udhëzimeve për marrjen e masave të sigurisë në veprimtarinë e sektorëve të veçantë"*.

Bazuar në dispozitat e lartpërmenduara, si organi kompetent rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të drejtën e informimit, Komisioneri ka nxjerrë Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor".

Nga ana tjetër, Udhëzimi nr. 4059/2, datë 07.06.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave", është një akt nënligjor i dalë në bazë dhe për zbatimin e Udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor". Për rrjedhojë, ky akt nuk mund të vijë në kundërshtim apo të prevalojë mbi aktin nga i cili i buron fuqia juridike.

Për më tepër, ndryshe nga Udhëzimi nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", i cili në pikën 4 të Kreut IV, të tij përcakton rregulla specifike për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale për vendimet penale, në Udhëzimin nr. 4059/2, datë 07.06.2016 "Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave", të Ministrit të Drejtësisë, nuk gjendet një rregullim i tillë.

Nga sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të rishikojë anonimizimin e informacionit duke mbajtur në konsideratë Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", konkretisht pikën 4, të Kreut 4,

e cila parashikon se: "Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile (të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtëm, në mbrojtje të privatësisë:

a) Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.

b) Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave)."

Në lidhje me pretendimin e ankuesit, për vënien në dispozicion të vendimeve të plota, të anonimizuara vetëm për të dhënat që janë sensitive dhe të lidhura me persona të tretë, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi vjen në kundërshtim me udhëzimin e sipërcituar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1694 Prot., datë 29.12.2020 të z. _____, kundër Autoritetit Publik "Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë", me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 11.11.2020, duke respektuar anonimizimin sipas udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor", konkretisht: (1. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 – 2020 me objekt: "Vendosjen e sekuestros preventive" të pasurive që dyshohet se janë produkt i veprimtarisë kriminale, në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal. 2. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 - 2020 me objekt: "Revokimin/heqjen e sekuestros preventive" të pasurive të dyshuara si produkt i veprimtarisë kriminale, të marra në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal. 3. Të gjitha vendimeve të marra gjatë periudhës 2010 - 2020 me objekt: "Konfiskimin e pasurisë", në zbatim të nenit 287 të Kodit Penal), brenda datës 24 . 2 .2021.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja e tij, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17.2.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

